Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Sahit Beqiri - Ekspert Shqyrtues _____	*Data e autorizimit të ekspertit:* **15.06.2022**	*Data e dorëzimit të raportit:* **20.06.2022**	*Nr. i lëndës:* **167/22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **27.05.2022**, grupi iOE ankues: **"AGS Corporation" Sh.p.k. & PK D.o.o., Prishtinë,** ka parashtruar ankesë me nr.: **167/22**, kundër **B58 njoftimit mbi vendimin e AK, (vendimit për dhënie të kontratës),** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me Rimorkio për kamion për nevoja të FSK-së",** me nr. të prokurimit:**217-22-1493-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Ministria e Mbrojtjes.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedura e hapur**, lloji i kontratës: **Furnizim**, vlera e parashikuar e kontratës: **310.000,00 €**

Shënim: *Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nuk është nxjerr ndonjë vendim nga OSHP-ja.*

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: **"AGS Corporation" Sh.p.k. - Prishtinë**

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 10 i LPP-së
Neni 11 i LPP-së
Neni 28 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 108/A – i LPP-së

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Te nderuar ne me dt. 13.05.2022 përmes platformës elektronike e-prokurim jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-se, ku është rekomanduar për kontrate OE Ideal Shala B.I., ndërsa ne jemi shpallur si tenderues te eliminuar me arsyetimin se: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: I pa-përgjegjshëm nuk ka plotësuar minimumin e kërkesave te përcaktuara ne DT dhe ne njoftimin për kontrate sepse:

- Specifikimet teknike te detyrueshme (aneksi 1) nuk përputhen komplet me specifikimet teknike (aneksi 1) te kërkuara ne DT (te rimorkio 30t te ngjyra, te rimorkio 20t t epesha bruto nuk është ne përputhje me specifikim teknik te kërkuar ne DT
- Te ngarkesa nuk është ne përputhje me specifikim teknik te kërkuar ne DT
- Te ngjyra: është kërkuar ngjyra e gjelbër ushtarake RAL 6031 ne katalog s'ka kod shkruan vetëm olive green.

- Te anësoret: 2x ramp atë ngarkimit me thyerje te gjata 2400+1800x700mm (+-5) nuk është ne përputhje me specifikim teknik te kërkuar ne DT.
- Te Cikrik: Mounting bolt pattern: Universal Standart nuk e ka ne katalog ofertuesi
- Te pajisjet: dy jastëkë pyke për rrotat e rimorkios qe peshoje për rrotat e rimorkios qe peshoje me shume se 10 me kllapat e përshtatshme ne pjesën e jashtme te rimorkios nuk e ka ne katalog ofertuesi

Te sqarimet plotësuese dhe te detyrueshme mungojnë:

- Rimorkiot duhet te jene te prodhuara me standarde te BE-se
- OE fitues para porositjes se pozicionit obligohet te bëjë koordinim paraprak qe rimorkiot te përshtaten me automjete e FSK-se (ne lartësi, gjatuesi dhe gjerësi sa i përket biges)

Fillimisht ju sqarojmë se ne me dt. 16.05.2022 kemi kërkuar qasje ne dokumente te OE te rekomanduar për kontrate, kurse AK-ja nuk na ka lejuar qasje te plote ne ofertën e OE te rekomanduar për kontrate.
Ju sqarojmë se arsyet e AK-se për eliminimin tone nga ky aktivitet i prokurimit janë te paqëndrueshme për faktet si ne vijim:

Ne arsyen e pare te eliminimit është cekur si e vijim:
Specifikimet teknike te detyrueshme (aneksi 1) nuk përputhen komplet me specifikimet teknike (aneksi 1) te kërkuara ne DT (te rimorkio 30t te ngjyra, te rimorkio 20t t epesha bruto nuk është ne përputhje me specifikim teknik te kërkuar ne DT
Te ngarkesa nuk është ne përputhje me specifikim teknik te kërkuar ne DT
Te ngjyra: është kërkuar ngjyra e gjelbër ushtarake RAL 6031 ne katalog s'ka kod shkruan vetëm olive green.

Ju sqarojmë se arsyetimi i lartcekur i AK-se, është i pa bazuar për faktin se kërkesë e dosjes se tenderit ka qene "*rimorkio 20t dhe është kërkuar pesha bruto 24000 – 26000 kg*". Ne lidhje me këtë kërkesë janë kërkuar sqarime shtese gjate fazës se tenderimit nga një operator ekonomik, ku i njëjti ka parashtruar pyetjen, se a lejohet te ofertohet me peshe me te mëdha se sa pesha e kërkuar ne dosje te tenderit me arsyetimin e shpërndarjes se ngarkesave ne tri akse. AK-ja ne përgjigjen e saj e ka cekur se lejohet te jete pesha edhe me e madhe se sa qe është kërkuar.
Këto sqarimet e bëra nga AK-ja ligjërisht bëhen pjese e dosjes se tenderit, prandaj rezulton se ne kemi ofertuar sipas kërkesave te dosjes se tenderit dhe specifikimeve teknike.
Kur merret parasysh ky fakt, atëherë rezulton se ne jemi eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit ne mënyrë te kundërligjshme dhe jemi diskriminuar ne këtë rast.

Ndërsa sa i përket arsyes se AK-se, për eliminimin tone ne lidhje me ngjyrën e rimorkios, ku e njëjta e ka cekur se ne katalog tek ngjyra nuk figuron kodi, mirëpo shkruan vetëm olive green, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i AK-se për eliminimin tone është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar.

Nëse analizohet specifikimi teknik, shihet se është kërkuar qe te ofrohet "*Komponentët e celikut: te gerryer ne cilësinë SAE 2.5 – Shasi: E gjelbër ushtarake mat RAL 6031*" ndërsa ne katalogun te cilin ne e kemi prezantuar ne oferte (Katalog PRS 360 fq. 1-6), shihet qarte se ngjyra e rimorkiova te ofruara nga ne, është prezantuar me komponentin e kërkuar SAE 2.5 dhe është ngjyre e gjelbër ulliri. Përderisa ne kemi ofertuar me rimorkio qe dot e prodhohet dhe te njëjtat dot e përdoren ekskluzivisht për nevoja ushtarake, atëherë është obligative qe ngjyra e rimorkiova do te jetë mat e gjelbër ushtarake. Ju sqarojmë se ne këto rimorkio i kemi liferuar me pare për nevojat e FSK-se ne vitin 2019, ku te cilat janë pranuar me te njëjtat kritere dhe ngjyre nga ana e AK-se. Prandaj ne këtë raste as nuk dot e ishte ngritur një dilemë e tillë nga ana e AK-së, sepse kane përvojë kompaninë tonë përkitazi me furnizimin e këtyre pajisjeve, e te cilat kane qene kualitative dhe sipas specifikeve teknike.

Nëse eventualisht ka ekzistuar ndonjë dilemë nga AK-ja, përkitazi me ngjyrën atëherë kanë mundur te kërkojnë sqarime shtesë konforme dispozitave te nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, për te qartësuar gjendjen reale dhe me qellim te mos diskriminimit tone si OE i përgjegjshëm, ndërsa edhe ne këtë rast AK-ja nuk e ka ndërmarr një veprim te tille duke shprehur ne një mënyrë njëanshmërinë ne vlerësimin e tenderëve dhe njëkohësisht ne diskriminimit e kompanisë tone.

Arsye tjetre e eliminimit ka qene se kinse ne jemi te papërgjegjshëm për faktin se:

- Te anësoret: 2x ramp atë ngarkimit me thyerje te gjata 2400+1800x700mm (+-5) nuk është ne përputhje me specifikim teknik te kërkuar ne DT.

Ne lidhje me arsyetimi e lartcekur te AK-se, ju sqarojmë se i njëjti arsyetim është ipa qëndrueshëm dhe i pabazuar për faktin se edhe ne lidhje me anësoret janë bere pyetje sqaruese drejtuar AK-se, ku një OE ka kërkuar qe te lejohet devijimi ± 5% nga këto specifika, ndërsa AK-ja te njëjtit ika kthyer përgjigje duke e sqaruar se lejohet devijimi i lartcekur. (**Bashkangjitur keni përgjigjet e AK-se ne pyetjet sqaruese**). Edhe pse këto mund te konsiderohen devijime te vogla qe nuk shkaktojnë ndonjë ndryshim material sipas nenit 59.4 te LPP-së.

Përderisa AK-ja, ka lejuar devijimin e lartcekur, atëherë ne nuk është dashur te eliminohemi nga ky aktivitet i prokurimit, sepse siç e cekem edhe me lart përgjigjet e AK-së janë te vlefshme për te gjithë OE ofertues. Mirëpo edhe ne këtë rast nëse eventualisht AK-ja ka pasur ndonjë dileme, atëherë e njëjta ka mundur shume lëshetë te vërtetoj pretendimin tone ankimore, duke kërkuar sqarime shtese konforme dispozitave te nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së.

AK-ja na ka eliminuar edhe për një arsye tjetre, ku e njëjta e ka cekur se:

- Te Cikrik: Mounting bolt pattern: Universal Standart nuk e ka ne katalog ofertuesi

Kjo arsye e eliminimit, është me te vërtetë joprofesionale dhe diskriminues, sepse bulonat e lartcekur, janë bulona standard e te cilët ne mendojmë qe është e panevojshme te prezantohen ne katalog, për faktin se bulona te tille janë te shumët dhe ka qindra lloje te ndryshme. Te gjitha masat dhe modelet e bulonave është e pa mundur, e panevojshme dhe e pakuptimte te prezantohen ne katalog, ndërsa vlen te ceket fakti se asnjë prodhues serioz nuk i paraqet ato ne katalogët e tyre zyrtare. Bulonat për te cilat AK-ja na ka eliminuar po i paraqesim me poshtë me foto, ku shihet qarte se bulona te tille janë te shumte ne mase dhe modelet te ndryshme dhe janë pjesë shumë te vogla qe zakonisht nuk përfshihen ne katalogë.

Zakonisht ne katalogë prezantohen pjesët kryesore te pajisjeve dhe vete pajisjet, mirëpo disa elemente qe nuk janë kryesore nuk prezantohen ne katalogë, mirëpo se a i prodhojnë këto pjese te vogla prodhuesit apo jo, mundet shume lehte te vërtetohet ne mënyra tjera, duke kërkuar sqarime shtesë apo ndonjë informacion tjetër. Autoriteti kontaktues ne raport me kompaninë tone nuk e ka përdorur fare dispozitën e nenit 59.2 dhe 2 te LPP-se, për te qartësuar ndonjë dilemë eventuale, prandaj ky veprim i AK-së na bënë te dyshojmë se AK-ja ne mënyrë subjektive e ka krijuar bindjen për fituesin qysh ne fillim te vlerësimit dhe në këtë drejtim na ka diskriminuar neve si kompani serioze dhe e përgjegjshme ne këtë aktivitet te prokurimit.

Ne jemi eliminuar nga ana e AK-se edhe me një arsye tjetër, ku AK-ja e ka cekur si ne vijim:

- Te pajisjet: dy jastëkë pyke për rrotat e rimorkios qe peshoje për rrotat e rimorkios qe peshoje me shume se 10 me kllapat e përshtatshme ne pjesën e jashtme te rimorkios nuk e ka ne katalog ofertuesi

Arsyetimi i lartcekur i AK-se është vetëm një pretekst për te na eliminuar neve si OE te përgjegjshëm ne këtë aktivitet te prokurimit, për faktin se Pykat Jastëk janë pjesë – pajisje përcjellëse e te cilat vijnë obligativisht me rimorkio, pra te njëjtat janë pjesë obligative e rimorkios. Vlen te ceket fakti se pykat e njëjta janë dorëzuar nga ana jone me rimorkiot e liferuar ne vitin 2019 si pjese bazike obligative e rimorkiove. Gjithashtu edhe këto pjese te vogla nuk paraqiten te gjitha ne katalog, mirëpo dihet qe janë pjesë përbërëse e rrotave te rimorkios.

Edhe ne këtë rast, nëse eventualisht AK-ja ka pasur dilema ne lidhje me pajisjet e lartcekura e njëjta ka mundur edhe është dashur te kërkoj sqarime shtese konforme dispozitave te nenit 59.2 dhe 2 te LPP-së, mirëpo qe një veprim te tillë nuk e ka ndërmarr duke ne diskriminuar neve si OE te përgjegjshëm ne këtë aktivitet te prokurimit. Është për tu çuditur veprimi i AK-së për te mos kërkuar sqarime shtese nga kompania jonë për ndonjë kërkesë apo specifikim përkatës.

Po ashtu AK-ja tek njoftimi mbi vendimin e saj si arsye tjetër për eliminimin tone e ka cekur se:

Te sqarimet plotësuese dhe te detyrueshme mungojnë:

- Rimorkiot duhet te jene te prodhuara me standarde te BE-se
- OE fitues para porositjes se pozicionit obligohet te beje koordinim paraprak qe rimorkiot te përshtaten me automjete e FSK-se (ne lartësi, gjatuesi dhe gjerësi sa i përket biges)

Arsyeja e lartcekur e AK-së për eliminimin tone, sa i përket çështjes se rimorkiot duhet te jene sipas standardeve te BE-se, është e paqëndrueshme, për faktin se ne, me dosje te tenderit, kemi bashkangjitur edhe dokumentin: EC Izjava o suglasnosti PRS360-PRT360 – Deklaration of Conformity, me ane te se cilës shihet qartë qe rimorkiot e ofruara nga ana jone janë te prodhuara me te gjitha standardet e BE-se dhe i posedojnë te gjitha certifikatat e nevojshme. Për ne është e çuditshme se si AK-ja nuk i ka analizuar këto dokumente, mirëpo ka nxjerre vetëm arsyetime te cilat janë te paqëndrueshme, pasi qe nëse analizohet dokumentacioni ynë, kuptohet se ne e kemi ofruar deklaratën e konformitetit me ane te se cilës shihet se rimorkiot janë te prodhuara konform standardeve te BE-së.

Po ashtu ju sqarojmë qe anëtari i konsorciumit PK d.o.o. është prodhues i njohur i rimorkiove ushtarake dhe vjen nga një shtet qe është anëtarë i BE-së dhe rrjedhimisht është i obliguar qe ti plotëson te gjitha kriteret e prodhimit me standarde te BE-se. (Referojuni dokumentit me nr. rendor 18 – EC Izjava o suglasnosti PRS360-PRT360 si dhe dok. 21 – ISO Certifikata e prodhuesit) – Rimorkiot e tilla nga i njëjti prodhues janë dorëzuar ne FSK gjate vitit 2019.
Ndërsa nëse AK-ja ka pasur dilema ne lidhje me dokumentet e prezantuara nga ana jone, atëherë e njëjta ka mundur te kërkoj sqarime shtese konforme dispozitave te nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së.

Ne lidhje me këtë kërkesë, vlen te ceket fakti se AK-ja po përdorë **standarde te dyfishta** ne këtë aktivitet te prokurimit, pasi qe ne edhe pse e kemi ofruar deklaratën e konformitetit jemi eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka ofertuar vetëm një deklarate te tij (jo te prodhuesit) përmes se cilës vetëm deklaron se rimorkiot e ofruara do te jene te prodhuara me standarde te BE-se.
Pra AK-ja ne raport me OE e rekomanduar për kontrate, po e merr parasysh vetëm një deklarate te OE e cila nuk është e lëshuar nga prodhuesi, ndërsa neve edhe pse kemi ofruar deklaratën e konformitetit, po na eliminon nga ky aktivitet i prokurimit.
Kur analizohet kjo paralele qe e tërheqim ne, atëherë rezulton se AK-ja e ka favorizuar hapur OE e rekomanduar për kontrate, ndërsa na ka diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm.
Ne lidhje me këtë rast kërkojmë nga eksperti shqyrtues qe te analizoje ne detaje këtë pretendim dhe vihet ne përfundim te saktë se cili dokument është ne përputhje te plote me kërkesën e AK-së.
Nga autoriteti kontraktues, neve nuk na merret për baze deklarata e konformitetit, kurse OE te rekomanduar për kontrate i merret parasysh një deklarate e përpiluar nga OE i rekomanduar për kontrate se rimorkiot janë te prodhuara me standarde te BE-se. Si ka mundësi qe ta dëshmoj OE i rekomanduar për kontrate një deklarim te tillë. Për me tepër OE i rekomanduar për kontrate nuk ka kompetence qe te beje një deklarate te tillë përderisa nuk është prodhues. Nëse do te kishin një siguri te tille qe rimorkiot do te prodhohen sipas standardeve te BE-se atëherë prodhuesi do ta bënte një deklarate te tille e jo OE i rekomanduar për kontrate qe nuk është prodhues.
Pra ne këtë raste neve nuk na merret parasysh dëshmia konkrete nga prodhuesi, kurse OE te rekomanduar për kontrate i merret parasysh një premtim i bere nga vete OE i rekomanduar për kontrate, madje ky premtim nuk është i bere as nga vete prodhuesi.

Ndërsa sa i përket arsyes tjetër te AK-se për eliminimin tonë, ne lidhje me kinse mungesën e dokumentit për përshtatjen e rimorkiove me automjetet e FSK, ju sqarojmë se me këtë arsyetim AK-ja edhe një here po tregon qartë diskriminimin e hapur qe i ka bere kompanisë tonë si OE te përgjegjshëm, pasi qe e njëjta sipas arsyes se lartcekur, po na jep te kuptojmë se nuk i ka analizuar ne tërësi dokumentet e prezantuara nga ana jone apo qëllimshëm nuk i merr për bazë. Nëse analizohet oferta jone edhe dokumentet e prezantuara nga ne, shihet qartë se ne e kemi ofruar deklaratën e veçante te nënshkruar dhe vulosur nga te dy anëtaret e konsorciumit, ku ceket qartë se ky konsorcum obligohet qe te bëjë koordinimin paraprak qe rimorkiot te përshtaten me automjetet e FSK-së.

Dokumenti gjendet ne ofertën tone, përkatësisht tek dokumenti nr. 23 me titull Deklarata e Kërkuara, mirëpo qe AK-ja nuk i ka analizuar fare këto deklarata duke na diskriminuar haptas neve si OE te përgjegjshëm. (**Referojuni Dokumentit 23 – Deklaratat e kërkuara**).

Andaj duke u bazuar ne faktet e lartcekura, shihet qarte se arsyet e AK-se për eliminimin tone nga ky aktivitet i prokurimit janë te paqëndrueshme, te pa bazuara dhe te pa mbështetura ne dispozita ligjore te LPP-së dhe te pa mbështetura ne fakte konkrete, mirëpo janë vetëm pretekst për te na eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe përkundër faktit se ne jemi OE i përgjegjshëm.

Përveç diskriminimit te kompanisë tone, AK-ja ka rekomanduar për kontrate një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktet dhe arsyet si ne vijim:

OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm, për faktin se i njëjti ka bërë ndërhyrje ne katalogun e prodhuesit te cilin e ka prezantuar ne oferte. Nëse analizohet katalogu, përkatësisht faqet 2, 3, 4 dhe 5 i prezantuar nga i njëjti OE, shihet qartë se i njëjti ka kopjuar fotot e rimorkios nga dosja e tenderit dhe i ka vendosur si foto ilustrative ne katalog te cilin e ka prezantuar ne oferte.
Me poshtë po i bashkëngjisim disa nga fotot te cilat OE i rekomanduar për kontrate i ka kopjuar nga dosja e tenderit dhe i ka vendosur ne katalogun e prodhuesit:

Wheels & Tyres
12 pieces + 1 spare wheel, disc (wheel) steel with tire size R17.5, spare wheel mounted on the chassis in the lowering and raising mechanism.



Photo for illustration

www.emsmakina.com

Towing hook incorporated in the automatic helmet, in accordance with ECE 55-01, compatible with NATO standards
Length of the bracket 1500 mm, 50 mm, height of placement in the hook of the truck 1200 mm.

Photo for illustration

www.emsmakina.com

Duke u bazuar ne faktet e lartcekura, shihet qarte se OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm, pasi qe ka ndërhyrje ne katalog, ndërsa dihet qe katalogu ofrohet nga prodhuesi dhe i njëjti duhet te jetë origjinal nga prodhuesi dhe jo te bëhet ndërhyrje dhe te shtohen foto te pajisjeve te cilat prodhuesi nuk i pasur fare ne katalog. Tek dëshmia e kërkuar dokumentare është cekur shume qarte se duhet te ofrohet ***"Katalogu ose broshure – vetëm nga prodhuesi"***, ndërsa ne këtë rast OE i rekomanduar për kontrate ka ndërhyrë ne katalogun e prodhuesit me qëllim që të plotësojë kërkesën e dosjes se tenderit.
Ne nuk kemi bërë asnjë ndërhyrje ne katalogun qe na ka ofruar prodhuesi, pavarësisht qe nuk kanë qenë te përfshira ndonjë pajisje e vogël dhe për këtë arsye jemi eliminuar, kurse autoriteti kontraktues ka vepruar ne mënyrë favorizuese ndaj OE te rekomanduar për kontrate duke i tejkaluar këto parregullsi dhe ndërhyrje ne katalogun e prodhuesit.
Pra AK-ja ka përdorur standarde te dyfishta gjate ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te tenderëve, sepse mungesën e pjesëve te vogla ne katalogun e ofruar nga ne, e ka konsideruar shume te rëndësishme, ndërsa ndërhyrjen ne katalog nga ana e OE te rekomanduar për kontrate e ka llogaritur te rregulltë dhe normale.

OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm, edhe për faktin se ne dokumentet e prezantuara përkatësisht ISO certifikatat, ne asnjërën prej tyre nuk ceket qe prodhuesi ne fjalë është prodhues i makinerive dhe rimorkiove ushtarake, mirëpo ne te njëjtat figuron se i njëjti është prodhues vetëm i rimorkiove për përdorime civile, prandaj edhe për këtë arsye është dashur te eliminohet sepse rimorkiot civile dallojnë nga rimorkiot ushtarake.

I njëjti operator ekonomik është dashur te shpallet i papërgjegjshëm nga ana e AK-së, pasi qe ky aktivitet i prokurimit është i rëndësishëm dhe ka te beje menevojat e FSK-se. Andaj përderisa AK-ja e ka rekomanduar për kontrate këtë OE, atëherë kuptohet qartë se AK-ja nuk po i kushton rendësin e duhur ketij aktiviteti te prokurimit kur është ne pyetje OE i rekomanduar për kontrate pasi qe fituesi i këtij aktiviteti te prokurimit me prodhuesin qe oferton, duhet te posedoj përvojë ne prodhimin e makinerive dhe rimorkiove ushtarake dhe te garantohet kualiteti i këtyre rimorkiove.

OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk ka ofruar konform kërkesave te përcaktuara tek Specifikat teknike te rimorkios 20t me 3 akse për bartje te automjeteve, ku një nga kërkesat ka qene: "***OE duhet te ofroj manualet se paku ne gjuhen angleze për përdorim dhe mirëmbajtje te rimorkios***".
OE i rekomanduar për kontrate nuk e plotëson kërkesën e lartcekur, sepse nuk ka prezantuar ne ofertën e tij **Manualet e përdorimit te pajisjeve**, andaj është dashur te shpallet i papërgjegjshëm nga ana e AK-se. Papërgjegjshmëria e OE te rekomanduar për kontrate vërehet haptas me mungesën e ofrimit te këtyre dëshmive, mirëpo AK-ja nuk ka ndërmarr veprime te tilla ndaj këtij operatori ekonomik duke favorizuar atë dhe duke e rekomanduar për kantatë.

OE i rekomanduar për kontrate ashtu siç edhe e kemi cekur edhe me larte është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti ne lidhje me kërkesën **- Rimorkiot duhet te jene te prodhuara me standarde te BE-se**. Këtë pretendim e kemi sqaruar me larte tek arsyet e eliminimit te kompanisë tonë.

Deklarata e tille nuk duhet te merret parasysh për faktin se e njëjta deklarate nuk e vërteton me fakte konkrete se rimorkiot do te prodhohen sipas standardeve te BE-së, sepse e njëjta deklarate është bere nga vet OE i rekomanduar për kontrate dhe një deklarate e tille mund ta bëjnë te gjithë OE ofertues, mirëpo e njëjta nuk mund dhe nuk duhet te merret parasysh dhe nuk konsiderohet valide përderisa nuk lëshohet nga vet prodhuesi.
OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar as deklarate për A-test apo ndonjë sqarim edhe pse ka qene obligative te sqarohet dhe jepet te paktën një deklarate ne lidhje me këto A-teste, sipas Aneksit 1 te dosjes se tenderit.

Po ashtu ju sqarojmë se ne kemi bërë kërkesë për qasje te plote ne dokumentet e OE te rekomanduar për kontrate konform nenit 10.3 te LPP-se, mirëpo qe AK-ja nuk i ka respektuar dispozitat e nenit te lartcekur, për faktin se nuk na ka ofruar qasjen ne te gjitha dokumentet e OE te rekomanduar për kontrate. OE i rekomanduar për kontrate ka plotësuar deklaratën për sekret afarist, ku e ka cekur se i tere dokumentacioni është sekret afarist.
Megjithatë neve na janë dhënë disa dokumente, mirëpo jo i tere dokumentacioni i OE te rekomanduar për kontrate.
Kërkesa e OE te rekomanduar për kontrate nuk i ka plotësuar kushtet e nenit 11.3 te LPP-së për tu konsideruar te gjithë dokumentacionin sekret afarist sepse nuk ka dëshmuar me ndonjë shkrese apo arsye se perse duhet te konsiderohet i tere dokumentacioni sekret afarist dhe nuk ka dëshmuar se për cilat dokumente mund te dëmtohet i njëjti operator ekonomik, nëse do te lejohet qasja ne këto dokumente, prandaj AK-ja e ka favorizuar hapur OE e rekomanduar për kontrate dhe njëkohësisht e ka shkelur dispozitën e nenit 10 dhe 11 te LPP-së.
Ne këtë rast, AK-ja është dashur te bëjë versionin e pastruar konform dispozitave te nenit 11.4 ku është përcaktuar qarte se: "4. *Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e "pastruar" të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji".*
Përderisa AK-ja nuk e ka bere versionin e pastruar dhe nuk kemi pasur qasje ne te gjitha dokumentet e OE te rekomanduar për kontrate, ne dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për arsye te tjera, siç janë: dyshimi se i mungon autorizimi nga prodhuesi ose dileri i autorizuar. Po ashtu dyshojmë se te njëjtit i mungon edhe referencat dhe kontratat e punëve te kryera konform kërkesës se FDT-së dhe te njoftimit për kontratë.
Pasi qe nuk na është lejuar qasje ne dokumentet e te njëjtit OE ne po i parashtrojmë këto pretendime dhe kërkojmë nga eksperti shqyrtues nxjerr konstatime me fakte konkrete ne lidhje me këto pretendime tona ankimore, pra te analizohet ne tërësi i tërë dokumentacioni dhe te konstatohet se a e ka autorizimin nga prodhuesi, nëse e ka a është konform FDT-së, a e ka listën e kontratave dhe referencat dhe nëse i ka a i ka konforme kërkesave të FDT-së.

Gjithashtu, dyshojmë ne vërtitësin e Walder Qualification Certifkate (katër certifikata te tilla), prandaj kërkojmë nga eksperti shqyrtues qe te konstatohet edhe vërtetësia e këtyre certifikatave, sepse ne dukje te pare duken ndërhyrje ne këto certifikata.

Duke u bazuar ne dispozitat e lartcekura shihet qarte se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur te konsiderohet edhe nga ana e AK-së, mirëpo qe një veprim te tillë e njëjta nuk e ka bërë, duke shfaqur edhe një herë veprimin favorizues ndaj OE te rekomanduar për kontratë.

Ne me dt. 20.05.2022 kemi pranuar vendimin për refuzim te kërkesës për rishqyrtim, ku ne këtë vendim nuk është dhënë asnjë përgjigje ne pretendimet tona ankimore, por vetëm është cekur se refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim, prandaj edhe ky fakt tregon qartë se kërkesa jonë për rishqyrtim dhe pretendimet tona ankimore kanë qenë te bazuara plotësisht dhe për këtë arsye AK-ja nuk ka mundur te jep përgjigje konkrete ne lidhje me këto pretendime ankimore.
Mos arsyetimi i vendimit për refuzim përbën shkelje te nenit 108/A paragrafi 9 i LPP-së, sepse aty ceket decidivisht "***Refuzimi do te arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, ne përputhje me këtë ligj, parashtruesit te ankesës dhe te gjitha palëve te interesuara, nëse ka ndonjë***".
Pra AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 108/A te LPP-së, sepse nuk është arsyetuar fare vendimi për refuzim te kërkesës për rishqyrtim, e qe ky veprim nënkupton se pretendimet tona ankimore kane qene te bazuara dhe me këtë rast edhe AK-ja ne mënyrë implicite e ka pranuar këtë fakt, me mos dhënien e përgjigjeve ne pretendimet tona ankimore.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet që u ceken me lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesore për dhënie te kontratës, e qe ka qene **tenderi i përgjegjshëm me çmim me të ulët sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse është rekomanduar për kontrate OE i cili është i papërgjegjshëm**.
Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 te LPP-se, ku edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e FDT-se dhe te njoftimit për kontrate nuk jemi rekomanduar për kontrate. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qarte qe "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente*. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qe *Gjate udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, te gjitha autoritetet kontraktuese do të siguroj: që (vi) qe tenderi i zgjedhur te përputhet me te gjitha aspektet përmbajtsore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse",* mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.
Ne këtë raste, AK-ja ka vepruar ne kundërshtim me ketë dispozite sepse tenderi/OE i rekomanduar për kontrate nuk është ne përputhje te plote me te gjitha kushtet përmbajtjesore dhe specifikimet e kërkuara, prandaj është dashur te eliminohet OE i rekomanduar për kontratë.
Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe nenin 1 te LPP-se, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroje mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove.
Duke u bazuar ne dëshmitë qe u ceken me larte, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, ankesa e grupit te OE**"AGS Corporation Sh.P.K. & PK d.o.o.** si e bazuar
ANULOHET, njoftimi mbi Vendimin e AK-së për dhënie te kontratës dhe lënda kthehet ne **RIVLERESIM**
DETYROHET, autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontrate dhe konform dispozitave te LPP-se.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucione tjera kompetente.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), nuk janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim pranë autoritetin, pasi qe ne ankesën pran OSHP ka shtuar **nenet 1, 10, 11, 69, 72 të LPP-së**, kurse
Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – nuk është të njëjta me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së, pasi që në ankesën pranë OSHP është plotësuar dhe ndyshuar.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional	***Dëshmia e kërkuar dokumentare***
Kërkesat: Kërkesa 08 OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 400,000.00 euro Kërkesa 09 OE duhet të paraqesë, tek Autoriteti kontraktues të paktën nga një foto për secilin produkt te ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave teknike të produkteve te lëshuara nga prodhuesi, me te cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara, siç kërkohet në specifikimet teknike (Aneksi 1) për te gjitha produktet qe oferton Kerkesa 10 OE ne rast se nuk është vet prodhues atëherë duhet të ofroje dëshmi autorizimin nga prodhuesi apo dileri i autorizuar nga prodhuesi për shitje te këtyre produkteve	**Evidencat:** Evidenca 08. OE duhet te ofroj deshmi a). Listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të ketij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE. b). Referencat ose fletet pranimet pranimet teknike në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive pose raportet e flete pranimeve te furnizime sherbimeve puneve është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë. Për referenca nga institucionet private duhet te dëshmohet qarkullimi bankar origjinal nga banka për vlerën referencës së prezantuar. Evidenca 09 Katalogu ose broshure- vetem nga prodhuesi Evidenca 10 Autorizimi duhet te jete me emër te projektit dhe numër te prokurimit për pjesët të këtij tenderi qe oferton. Autorizim për shitje i lëshuar nga prodhuesi ose dileri i autorizuar per secilen pjese qe oferton

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Sqarime plotësuese dhe të detyrushme:

- Rimorkiot duhet të jenë të prodhuara me standarde të BE-së .
- OE duhet te ofroj manualet se paku në gjuhen angleze për përdorim dhe mirëmbajtje të rimorkios.
- OE duhet te ofroj katalogun e pjeseve te ndërrimit për të gjitha nivelet e mirëmbajtjës te perfshihen te gjitha komponentet. Katalogu te jete ne versionin elektronik ose kopje fizike.
- ISO certifikata e prodhuesit të rimorkios.
- Certifikata e A-testit.
- OE duhet të ofroj garancion 3 vjeçar për rimorkio.
- OE duhet me shpenzimet e veta do ta kryej mirëmbajtjen – servisimin e rregullt përfshirë furnizimin me pjesët e nevojshme qe nevojitën për mirëmbajtje – servisim gjatë periudhës garantuese min 37 muaj sipas manualit të prodhuesit.
- Servisimi i rregullt duhet të kryhet në kazermat e FSK-së me pjesë dhe shpenzime të OE (përjashtimisht në raste kur nuk mund të kryhet brenda kazermave, atëherë OE duhet ta bartë rimorkion deri të servisi i tyre me shpenzime te veta).
- OE fitues para porositjes se pozicionit obligohet te bëje kodrinim paraprak qe rimorkiot te pershtaten me automjetet e FSK-së (ne lartesi, gjatesi dhe gjerësi sa i përket bigës)

VËREJTJE;

GJATË PËRGATITJES SË SPECIFIKACIONIT TEKNIK KA MUNDUR QË TË PËRMENDET EMRI I PRODHUESIT APO NDONJË ELEMENT ME EMËR TË CAKTUAR, MIRËPO PËR OFERTIM VLEJNË EDHE PRODUKTET ME SPECIFIKA TEKNIKE TË BARASVLERSHME DHE STANDARDE ME ATO TË DHËNA NË KETË DOSJE TË TENDERIT (aneksi 1 specifikimet teknike te detyrueshme) .

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Grupi i Operatoreve ekonomik AGS Corporation SH.p.k.; PK d.o.o.
Specifikimet teknike te detyrueshme (aneksi 1) nuk përputhen komplet me specifikimet teknike (aneksi 1) te kërkuara ne DT (te rimorkio 30t te ngjyra, te rimorkio 20t t epesha bruto nuk është ne përputhje me specifikim teknik te kërkuar ne DT
Te ngarkesa nuk është ne përputhje me specifikim teknik te kërkuar ne DT
Te ngjyra: është kërkuar ngjyra e gjelbër ushtarake RAL 6031 ne katalog s'ka kod shkruan vetëm olive green.
Te anësoret: 2x ramp atë ngarkimit me thyerje te gjata 2400+1800x700mm (+-5) nuk është ne përputhje me specifikim teknik te kërkuar ne DT.
Te Cikrik: Mounting bolt pattern: Universal Standart nuk e ka ne katalog ofertuesi
Te pajisjet: dy jastëkë pyke për rrotat e rimorkios qe peshoje për rrotat e rimorkios qe peshoje me shume se 10 me kllapat e përshtatshme ne pjesën e jashtme te rimorkios nuk e ka ne katalog ofertuesi
Te sqarimet plotësuese dhe te detyrueshme mungojnë:

Rimorkiot duhet te jene te prodhuara me standarde te BE-se
OE fitues para porositjes se pozicionit obligohet te bëjë koordinim paraprak qe rimorkiot te përshtaten me automjete e FSK-se (ne lartësi, gjatuesi dhe gjerësi sa i përket biges)

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

Qasja ne dokumentacionet te cilat gjenden ne platformën e-prokurimi qe janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet te prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitura nga operatoret ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, si dhe sqarimet e kërkuar nga ESH te datës: 17.06.2022 dhe përgjigjet e pranuara nga ZPP – Ministria e Mbrojtjes të njëjtën datë.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26)
///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-sëLIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).
///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).
///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "AGS Corporation" Sh.p.k. - Prishtinë

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka shkelur nenin 1, 10, 11, 69 te LPP-se dhe disa pretendime shtese tek Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet, tek ankesa pran OSHP-se te ndryshme nga kërkesa për rishqyrtim pran autoritetit kontraktues.

Duke pas parasysh se OE ankues në pajtim me **nenin 108/A të LPP-së**, ka pasur mundësi dhe është dashur që paraprakisht të gjitha pretendimet e veta ti parashtron pran AK, e që në rastin konkret OE ankuese, këto pretendim nuk e ka parashtruar fare pranë AK me kërkesën për rishqyrtim, **eksperti shqyrtues** bazuar në **nenin 109 të LPP-së** si dhe **paragrafit 9.2 të nenit 9** të dokumentit **F03 Rregullat për parashtrim te ankesave-verzioni 2**, ku thuhet: *"Ankesa do te dorëzohet ne origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues"* si dhe **neni 13 par. 9 i Rregullores së OSHP-së Nr. 01/2020, e datës 03.03.2020**në të cilën thuhet: "*Ankesat duhet të jenë të qarta, e shkurtër, dhe me pretendimet e supozuara që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së, nga ana e autoritetit kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues",* andaj nga të cekurat si më lartë pretendimet në fjalë nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK na ka eliminuar me arsyetimin se: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: I pa-përgjegjshëm nuk ka plotësuar minimumin e kërkesave te përcaktuara ne DT dhe ne njoftimin për kontrate sepse:

- Specifikimet teknike te detyrueshme (aneksi 1) nuk përputhen komplet me specifikimet teknike (aneksi 1) te kërkuara ne DT (te rimorkio 30t te ngjyra, te rimorkio 20t t epesha bruto nuk është ne përputhje me specifikim teknik te kërkuar ne DT
- Te ngarkesa nuk është ne përputhje me specifikim teknik te kërkuar ne DT

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne bazuar ne aneksi 1 te FDT-se, ku janë përshkruar specifikimet teknike për rimorkio 30t dhe 20 t me 3 akse për bartje, grupi OE ankues ne katalogun e prezantuar nga ana e tyre nuk është ne përputhje te plote me specifikimet teknike ne aneksin 1 te FDT-se, ku ne deklarate mbi faktet dhe argumente edhe operatori ekonomik ankues e potencon se "në katalog prezantohen pjesët kryesore te pajisjeve dhe vet pajisjet, mirëpo disa elemente qe nuk janë kryesore nuk prezantohen ne katalog" qe do te thotë se janë vetëdijshëm se disa elemente te kërkuar tek specifikimet teknike ne aneksin 1 te FDT-se nuk janë prezantuar ne katalog, andaj bazuar nenin 72 par. 2 te LPP-se, ku thote: "Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji", si dhe nenin 39.8 te RRUOPP, ku thote:

Problemi	Si te veprohet?	Neni i LPP-se
Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	*Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm*	*69*

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika **nuk janë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK me arsyetimin e eliminimit:

Te sqarimet plotësuese dhe te detyrueshme mungojnë: Rimorkiot duhet te jene te prodhuara me standarde te BE-se. OE fitues para porositjes se pozicionit obligohet te bëjë koordinim paraprak qe rimorkiot te përshtaten me automjete e FSK-se (ne lartësi, gjatuesi dhe gjerësi sa i përket biges)

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne dokumentet e ofruara dokumentet e nënshkruar nga konsorciumi te nënshkruar dhe te vulosura , ku thotë: "*gjithashtu, obligohemi që para porositjes se pozicionit obligohet te bëjë koordinim paraprak qe rimorkiot te përshtaten me automjete e FSK-se (ne lartësi, gjatuesi dhe gjerësi sa i përket biges)",* si dhe "Declaraton of Conformity" ne përputhet me direktivën e makinerive EC/EEC machinery directive 76/757, 76/760, 76/759, 76/758, 71/320, 77/538, 76/756, 92/23, 94/20, dhe 70/221, mirëpo askënd nuk ceket se keto direktiva janë sipas standardeve te BE-se, prandaj, sa i perket "koordinimit qe rimorkiot te përshtaten me automjete e FSK-se" grupi i operatoreve ekonomik ka plotësuar kërkesën e FDT-së, ndërsa lidhur me "Rimorkiot duhet te jene te prodhuara me standarde te BE-se", prandaj AK – komisioni i vlerësimit nëse ka pasur dilema ka qene i obliguar te veproj sipas **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së** dhe te sigurohet se OE plotëson kërkesën e FDT-së dhe të evidentohet në raportin e vlerësimit, lidhur me këto certifikata se a janë ne përputhje me standardet e BE-se, pasi qe selia e prodhuesit është ne vendin e një shteti anëtar te BE-se. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka rekomanduar për kontrate OE për faktin se i njëjti ka bërë ndërhyrje ne katalogun e prodhuesit te cilin e ka prezantuar ne oferte. Nëse analizohet katalogu, përkatësisht faqet 2, 3, 4 dhe 5 i prezantuar nga i njëjti OE, shihet qartë se i njëjti ka kopjuar fotot e rimorkios nga dosja e tenderit dhe i ka vendosur si foto ilustrative ne katalog te cilin e ka prezantuar ne oferte. Me poshtë po i bashkëngjisim disa nga fotot te cilat OE i rekomanduar për kontrate i ka kopjuar nga dosja e tenderit dhe i ka vendosur ne katalogun e prodhuesit:

Wheels & Tyres
12 pieces + 1 spare wheel, disc (wheel) steel with tire size R17.5, spare wheel mounted on the chassis in the lowering and raising mechanism.

Photo for illustration

www.emsmakina.com

Towing hook incorporated in the automatic helmet, in accordance with ECE 55-01, compatible with NATO standards
Length of the bracket 1500 mm, 50 mm, height of placement in the hook of the truck 1200 mm.

Photo for illustration

www.emsmakina.com

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, OE i rekomanduar për kontrate ka ngritur ne platformën elektronike e-prokurim autorizimin sipas FDT-se, dhe katalogun nga kompania "ERHAN MAKINA SISTEMLERI – EMS Makina" ne **formatin pdf,** ne pajtim me dosjen e tenderit, andaj lidhur me pretendimin se ka pas ndërhyrje ne katalog nga OE i rekomanduar për kontrate, OE ankues këto pretendime mund ti drejtohet institucioneve kompetent, pasi qe ne cilësinë e ekspertit shqyrtues, nuk jam kompetent dhe nuk mund te trajtojtohen nga eksperti shqyrtues.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka rekomanduar për kontrate OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm, edhe për faktin se ne dokumentet e prezantuara përkatësisht ISO certifikatat, ne asnjërën prej tyre nuk ceket qe prodhuesi ne fjalë është prodhues i makinerive dhe rimorkiove ushtarake, mirëpo ne te njëjtat figuron se i njëjti është prodhues vetëm i rimorkiove për përdorime civile, prandaj edhe për këtë arsye është dashur te eliminohet sepse rimorkiot civile dallojnë nga rimorkiot ushtarake.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, si dhe bazuar ne kriteret e përzgjedhjes dhe aneksin 1 te FDT-se, - dosje te tenderit si dokument thelbore për përgatitjen e tenderëve nga OE e interesuar, askënd nuk është kërkuar se këto pajisje – rimorkion duhet te prodhohen nga prodhues i makinerive dhe rimorkiova ushtarake, andaj konsideroj se duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka rekomanduar për kontrate OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk ka ofruar konform kërkesave te përcaktuara tek Specifikat teknike te rimorkios 20t me 3 akse për bartje te automjeteve, ku një nga kërkesat ka qene: "***OE duhet te ofroj manualet se paku ne gjuhen angleze për përdorim dhe mirëmbajtje te rimorkios***".

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar një deklaratë, ku thotë: "*deklaron se ne rast se shpërblehemi me kontrate si fitues ne këtë aktivitet te prokurimit dot e ofroj manualet se paku ne gjuhen angleze për përdorim dhe mirëmbajtje te rimorkios*", prandaj duke marr për baze se kjo ka qene kërkese e dosje se tenderit dhe OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar manualet e përdorimit dhe mirëmbajtjes, prandaj AK – komisioni i vlerësimit ka qene i obliguar te veproj sipas **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së** dhe te sigurohet se OE plotëson kërkesën e FDT-së dhe të evidentohet në raportin e vlerësimit, pasi qe ka dorëzuar katalogun, autorizimin dhe deklaratë lidhur me manualet e përdorimit. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 7

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka rekomanduar për kontrate OE ashtu siç edhe e kemi cekur edhe me larte është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti ne lidhje me kërkesën **- Rimorkiot duhet te jene te prodhuara me standarde te BE-se**. Këtë pretendim e kemi sqaruar me larte tek arsyet e eliminimit te kompanisë tonë. Deklarata e tille nuk duhet te merret parasysh për faktin se e njëjta deklarate nuk e vërteton me fakte konkrete se rimorkiot do te prodhohen sipas standardeve te BE-së, sepse e njëjta deklarate është bere nga vet OE i rekomanduar për kontrate dhe një deklarate e tille mund ta bëjnë te gjithë OE ofertues, mirëpo e njëjta nuk mund dhe nuk duhet te merret parasysh dhe nuk konsiderohet valide përderisa nuk lëshohet nga vet prodhuesi.
OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar as deklarate për A-test apo ndonjë sqarim edhe pse ka qene obligative te sqarohet dhe jepet te paktën një deklarate ne lidhje me këto A-teste, sipas Aneksit 1 te dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar deklaratë ku thotë: "*Se rimorkiot e ofruara ne këtë aktivitet te prokurimit do te jene te prodhuara me standarde te BE-se*", mirëpo nuk ka ofruar ndonjë dëshmi nga prodhuesi se këto pajisje do te jene te prodhuara sipas standardeve te BE-se, gjithashtu mungojnë A-teste, prandaj AK – komisioni i vlerësimit ka qene i obliguar te veproj sipas **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së** dhe te sigurohet se OE plotëson kërkesën e FDT-së dhe të evidentohet në raportin e vlerësimit, pasi qe ka dorëzuar katalogun, autorizimin dhe deklaratë lidhur me standardet e BE-se. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 8

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Ne me dt. 20.05.2022 kemi pranuar vendimin për refuzim te kërkesës për rishqyrtim, ku ne këtë vendim nuk është dhënë asnjë përgjigje ne pretendimet tona ankimore, por vetëm është cekur se refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim, prandaj edhe ky fakt tregon qartë se kërkesa jonë për rishqyrtim dhe pretendimet tona ankimore kanë qenë te bazuara plotësisht dhe për këtë arsye AK-ja nuk ka mundur te jep përgjigje konkrete ne lidhje me këto pretendime ankimore.

Mos arsyetimi i vendimit për refuzim përbën shkelje te nenit 108/A paragrafi 9 i LPP-së, sepse aty ceket decidivisht "***Refuzimi do te arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, ne përputhje me këtë ligj, parashtruesit te ankesës dhe te gjitha palëve te interesuara, nëse ka ndonjë***".

Pra AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 108/A te LPP-së, sepse nuk është arsyetuar fare vendimi për refuzim te kërkesës për rishqyrtim, e qe ky veprim nënkupton se pretendimet tona ankimore kane qene te bazuara dhe me këtë rast edhe AK-ja ne mënyrë implicite e ka pranuar këtë fakt, me mos dhënien e përgjigjeve ne pretendimet tona ankimore.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues përmes platformës elektronike e-prokurim ka pranuar kërkesë për rishqyrtim me date 15.05.2022, ndërsa ZPP ka pezulluar a ktivitetin e prokurimit ne platformën elektronike, duke vepruar ne pajtim me **nenin 108/A par. 2 te LPP-së,** ku thotë: "*Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar*", pastaj ZPP me date 20.05.2022 përmes platformës elektronike e-prokurim nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke mos vepruar ne pajtim te plote me **nenin 108/A par. 9 te LPP-se**, ku thotë: "*Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.*" si dhe **nenin 108/A par. 12 te LPP-se, ku thotë:** *Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë",* që do të thotë se AK – ZPP ka qene i obliguar te veproj ne pajtim te plote sipas nenev dhe sqarime si me larte, pasi qe vendimi i nxjerr nga ZPP i datës 20.05.2022 i mungon pjesa kryesore – dispozitivi (arsyetimi i refuzimit te kërkesë për rishqyrtim). Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi nr. 9

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka rekomanduar për kontrate OE ne po i parashtrojmë këto pretendime dhe kërkojmë nga eksperti shqyrtues nxjerr konstatime me fakte konkrete ne lidhje me këto pretendime tona ankimore, pra te analizohet ne tërësi i tërë dokumentacioni dhe te konstatohet se a e ka autorizimin nga prodhuesi, nëse e ka a është konform FDT-së, a e ka listën e kontratave dhe referencat dhe nëse i ka a i ka konforme kërkesave të FDT-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dokumentet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar autorizimin ashtu siç kam dhen sqarim tek pretendimi me nr. 4, ndërsa lidhur me pretendimin sa i përket, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 te FDT-se, kerkesa8/evidenca 8, sqaroj se OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar listën e kontratave me referenca dhe pranime teknik, mirëpo vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve është ne diskrecion te AK, respektivisht komisionit te vlerësimit, dhe AK – komisioni i vlerësimit nuk kanë hasur ne ndonjë dyshim lidhur me këtë pike. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

Gjithashtu, **Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **nuk ka respektuar ne tërësi nenin 7, 59, 72, 108/A të LPP-së**, dhe **nenin 39.8 te RRUOPP-së**, andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e grupit te OE: **"AGS Corporation" Sh.p.k. & PK D.o.o., Prishtinë**, **aprovohet si pjesërisht e bazuar**, dhe rekomandon të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK (*vendimit për dhënie të kontratës*) dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim,** duke respektuar në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *OE ankues – "AGS Corporation" Sh.p.k. & PK D.o.o., Prishtinë,*